



Urdhëresa Nr. 01/02, për sigurimin e ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare gjatë emergjencës së shëndetit publik (Urdhëresa Nr.01/02), e datuar 17/03/2020

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike ("Ministria") me anë të Urdhëresës Nr.01/02 ka për qëllim rregullimin e komunikimit elektronik gjatë periudhës së emergjencës së shëndetit publik.

Kjo Urdhëresë urdhëron të gjithë ofruesit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve të sigurojnë qasje të pandërprerë në komunikime elektronike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, kjo Urdhëresë specifikon se ofruesit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike duhet të japin përparësi absolute komunikimeve të:

- Shërbimeve emergjente, duke u siguruar qasje të pandërprerë institucioneve që ofrojnë shërbime të thirrjeve emergjent, përfshirë këtu komunikimet epidemiologjike me urgjencë të skajshme, siç përkufizohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe Ministria e Shëndetësisë.
- Shërbimeve të mësimdhënies përmes internetit, të organizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Shërbime të tjera përmes internetit që Institucionet e Republikës së Kosovës mund t'i vënë në dispozicion qytetarëve.

Shërbimet e cekura më lartë nuk mund të ndërpriten edhe nëse klienti nuk përmbush detyrimet. Kjo nuk nënkupton se klienti lirohet nga detyrimet. Ofruesit e shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe postare duhet të punojnë në masë të domosdoshme dhe t'u shërbejnë qytetarëve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, përveç zonave të cilat Qeveria ka vendosur ndryshe, në përputhje me situatën e krijuar.

Shërbimet postare në zonat e rrezikshmëri të lartë, do të organizohen varësisht nga situata. Por ato edhe mund të pezullohen. Kjo urdhëresë mbetet në fuqi deri me përfundimin e emergjencës së shëndetit publik me vendim të Qeverisë.

Të gjithë operatorët ekonomik të cilët nuk do respektojnë këtë Urdhëresë do të ndëshkohen konform ligjeve të aplikueshme.

Ky dokument behet vetëm për qëllime informative. Nuk përbën këshillë ligjore dhe / ose angazhim të cdo lloji natyre. Për çdo sqarim ju lutem kontaktoni:

tax_legal-alkos@deloittece.com



Ordinance No. Nr. 01/02, on ensuring electronic communication services as well as postal services during the Public Health Emergency dated 17/03/2020

The Ministry Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments ("Ministry") through Ordinance No.01/02 has regulated the electronic communication during the period of Public Health Emergency.

This Ordinance orders service providers of electronic and network communications to ensure uninterrupted access to electronic communication for the entire territory of the Republic of Kosovo.

Additionally, this Ordinance orders the service provider of electronic and network communication to provide:

- Emergency services, by ensuring uninterrupted access to institutions who provide emergency call services, including here epidemiological communications with extreme urgency, as defined from the World Health Organization (hereafter: WHO), and the Ministry of Health;
- Educational services through the internet, organized by the Ministry of Education, Science, Technology and Innovation;
- Other internet services for Institutions of Republic of Kosovo that might provide to disposal of citizens.

The abovementioned services shall not be interrupted, even if the client does not fulfil its obligations. This does not mean that the client is cleared from obligations. The service providers of electronic, networking and postal services shall work only at necessary level and to serve to all citizens in the whole territory of Republic of Kosovo, except in the zones that the Government of Kosovo has decided otherwise, in accordance with created situation.

Postal serviced in the zones with higher risk, will be organized depending on the situation. However the postal services may be suspended. This ordinance remains into force until the Government through decision abrogates the emergency of public health.

The economic operator that do not comply this ordinance shall be subject to punishment in accordance with the applicable legislation.

This document is delivered for informative purposes only. It does not constitute legal/tax counsel and/or commitments of any nature. For any further clarification please contact:
tax_legal-alko@deloittece.com